



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



PRANUAR ME:

ACCEPTED ON:

PRIMLUNO:

Nr.No.Br.

05-07-2017

02/221

Kuvendi i Komunës
Nr. 02/
Datë: 03.07.2017

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenin 17 shkronja o, neni 40 paragrafi 2 shkronja i, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 24 paragrafi 1 të Ligjit nr.04/L-071 për Sistemin e Adresave, mbështetur në nenin 10 paragrafi 1 shkronja o, neni 19 paragrafi 7 shkronja j, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 datë: 12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë: 30.06.2017 mori këtë:

V E N D I M

PËR EMËRTIMIN E STADIUMIT TË QYTEZËS SË MALISHEVËS ME EMRIN E DËSHMORIT
TË KOMBIT "LIMAN GEGAJ"

Neni 1

Miratohet kërkesa nr.01/796 e datës: 28.06.2017 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për emërtimin e Stadiumit të Qytezës në Malishevë, me emrin e Dëshmorit të Kombit "Liman Gegaj" nga fshati i Ri, Komuna e Malishevës.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Urbanizëm dhe Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 3

Ky vendim do të hyjë në fuqi nga dita e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, përkatësisht pas plotësimit të kriterëve ligjore të parapara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës.

Vendimi iu dërgohet:
Arkivit të Komunës
Drejtorive të KK-së
MAPL-së.

Kryesuesi i Kuvendit
Dr. Aziz Thaci



PRANUAR MË: 24-07-2017
ACCEPTED ON: 24-07-2017
PRILBJENO:
Nr.No.Br. 02/299



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/_____

Datë: 24.07.2017

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenit 40 paragrafi 2 pika e, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në bazë të nenit 16 dhe 19 të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në vazhdimin e mbledhjes së VII (shtatë) të mbajtur me datë: 21.05.2017 mori këtë;

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR TRAJTIMIN E PETICIONIT TË LAGJES SË “GURIT” NË MALISHEVË

Neni 1

Miratohet vendimi për formimin e Komisionit për trajtimin e Peticionit të parashtruar nga banorët e Lagjes së “Gurit” në Malishevë.

Neni 2

Mbështetur në nenin 1 të këtij vendimi, komisioni do të jetë në përbërje prej 7 anëtarëve;

1. Rifat Mazreku nga Nisma për Kosovën, anëtar
2. Bekim Hoti nga PDK, anëtar
3. Labinot Gashi nga LDK, anëtar
4. Jetmire Vrenezi nga VV, anëtar
5. Blerim Thaçi nga drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe shërbim pronësoro juridik, anëtar
6. Milazim Morina nga drejtoria për Shërbime Publike, anëtar
7. Muharrem Morina nga zyra e Kryetarit të Komunës, anëtar

Neni 3

Ky Komision do të merret me shqyrtimin dhe trajtimin e Peticionit, dhe në bazë të gjeturave të rekomandoje Kuvendit të Komunës për vendosje.

Neni 4


Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kuvendi i Komunës.

Neni 5

Ky vendim do të hyjë në fuqi nga dita e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, përkatësisht pas plotësimit të kriterëve ligjore të parapara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës.

Vendimi ju dërgohet;
Arkivit të Komunës
MAPL-së.

Kryesuesi i Kuvendit
Dr. Aziz Thaçi





PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRANLJIM:

Nr.No.Br.

03.07.2017

02/216



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/

Datë: 03.07.2017

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenit 24 paragrafi 1, nenit 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, mbështetur në Ligjin nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, si dhe bazuar në nenin 19.7 pika b të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës: 12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë: 30.06.2017 mori këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E KORNIZES AFATMESME BUXHETORE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS
2018-2020

Neni 1

Miratohet Korniza afatmesme buxhetore e Komunës së Malishevës (KAB) për vitet 2018-2020, me theks të veçantë për vitin 2018.

Neni 2

Korniza afatmesme buxhetore për vitin 2018 përmban këta kufij buxhetorë ;

Paga dhe medijtje : 7,810,840.00

Mallra dhe sherbime : 1,058,501.00

Komunali: 355,000.00

Subvencione dhe transfere: 100,000.00

Investime kapitale: 4,367,395.00

Tatali: 13,691,736.00€

Neni 3

Kuvendi Komunal miraton KAB-in në kufijtë e përcaktuar nga Ministria e Financave në shumën 13,691,736.00€.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdesen, Kryetari i Komunës, dhe drejtorja për Ekonomi, Buxhet dhe Financa

Neni 5

Ky vendim do të hyjë në fuqi nga dita e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, përkatësisht pas plotësimit të kriterëve ligjore të parapara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës.

Vendimi ju dërgohet:

Arkivit të Komunës

Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

MAPL-së.

Kryesuesi i Kuvendit
Dr. Aziz Thaçi





REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës
Nr.02/
Datë: 03.07.2017

PRANJAN MË:

ACCEPTED ON

PRIMLORNO:

Nr.No.Br.

05-07-2017

02/222

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenit 24 dhe 40 paragrafi 2 pika c, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit nr.03/L-087 për ndërmarrjet Publike, Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Rregullores nr.02/244 datë:09.09.2015 për ndarjen e subvencioneve dhe transferëve, Statutin e Komunës së Malishevës Nr.01/871 të datës 12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e të mbajtur më datë: 30.06.2017 mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet kërkesa nr.01/732 datë:13.06.2017, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionim të kompanisë publike Komunale "Stacioni i Autobusëve " Sh.a, me seli në Malishevë.

Neni 2

Shuma prej 10,000.00€, lejohet për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës konform rregullave ligjore, të kësaj ndërmarrje lokale, pasi qe e njëjta është në stadin fillestar të krijimit.

Neni 3

Mjetet e lartcekura jepen si subvencion për ndërmarrjen, mirëpo Komuna e Malishevës ruan të drejtën e kthimit të mjeteve në rastet kur e njëjta ka afarizëm të suksesshëm.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdesët Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Financa dhe Buxhet.

Neni 5

Ky vendim do të hyjë në fuqi nga dita e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, përkatësisht pas plotësimit të kriterëve ligjore të parapara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës.

Vendimi ju dërgohet;
Arkivit të Komunës
Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
MAPL-së.

Kryesuesi i Kuvendit
Dr. Aziz Thaci





REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr.No.Br.

24-07-2017

22/298

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/_____

Datë: 24.07.2017

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenit 40 paragrafi 2 pika d, nenit 53 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe bazuar në nenin 19 dhe 28 në Statutin e Komunës së Malishevës Nr.01/871 datë: 12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në vazhdimin e mbledhjes së VII (shtatë) të mbajtur me datë: 21.07.2017 mori këtë;

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN
2017

Neni 1

Miratohet Plani i punës i Komitetit për Komunitete në Komunën e Malishevës për vitin 2017.

Neni 2

Plani i punës për vitin 2017, përfshinë gjithë punën dhe aktivitetet e përcaktuar nga Komiteti për Komunitete.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kuvendi i Komunës.

Neni 4

Ky vendim do të hyjë në fuqi nga dita e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, përkatësisht pas plotësimit të kriterëve ligjore të parapara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës.

Vendimi ju dërgohet:
Arkivit të Komunës
Anëtarëve të Komitetit
MAPL-së.

Kryesuesi i Kuvendit
Dr. Aziz Thaçi





REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



PROJAVAR DUE

ACCEPTED ON

PRILLOJTESH

Nr.No.Sr.

05-07-2017

02/223

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/

Datë: 03.07.2017

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja d, nenit 40 të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale, të dispozitave të nenit 7 të Ligjit nr.03/L-145 për fuqizimin dhe pjesëmarrje të rinisë, Rregullores nr.02/404 datë:06.11.2014 për fuqizimin dhe promovimin e vullnetarizmit në Komunën e Malishevës, nenit 10 të Statutit të Komunës së Malishevës nr. nr.01/871 të datës:12.11.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë: 30.06.2017 mori këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT RINOR LOKAL TË KOMUNËS SË MALISHEVËS
2017-2019

Neni 1

Miratohet Plani i veprimit rinor lokal i Komunës së Malishevës 2017-2019.

Neni 2

Plani i veprimit, i cekur në pikën I të këtij vendimi, është bazuar në dispozitat e ligjit në fuqi për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë dhe aktet nënligjore që rregullojnë veprimet rinore.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është kopja e Planit të veprimit rinor lokal i Komunës së Malishevës, për periudhën 2017 – 2019.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sportit.

Neni 5

Ky vendim do të hyjë në fuqi nga dita e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, përkatësisht pas plotësimit të kriterëve ligjore të parapara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës.

Vendimi ju dërgohet:

Arkivit të Komunës

Drejtorisë Kulturë, Rini dhe Sport

MAPL-së.

Kryesuesi i Kuvendit
Dr. Aziz Thaçi





REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA E KOSOVË
KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVE- KUPËRIA OPSHRE-MALISHEVO



PRANILAR MË:

ACCEPTED ON:

PRANILIM:

Nr. No. Nr.

24.07.2017

02/297

Kuvendi i Komunës
Nr. 02/
Datë: 24.07.2017

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenit 40 paragrafi 2 pika d, nenit 53 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe bazuar në nenin 19 dhe 28 në Statutin e Komunës së Malishevës Nr.01/871 datë: 12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në vazhdimin e mbledhjes së VII (shtatë) të mbajtur me datë: 21.07.2017 mori këtë;

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN
2016

Neni 1

Miratohet, raporti i punës nr.02/166 i datës:22.05.2017 i Komitetit për Komunitete për vitin 2016.

Neni 2

Raporti vjetor i punës për vitin 2016 përfshinë gjithë punën e organizuar nga Komitetit për Komunitete në Komunën e Malishevës.

Neni 3


Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kuvendi i Komunës.

Neni 4

Ky vendim do të hyjë në fuqi nga dita e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, përkatësisht pas plotësimit të kriterëve ligjore të parapara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës.

Vendimi ju dërgohet:
Arkivit të Komunës
Anëtarëve të Komitetit
MAPL-së.

Kryesuesi i Kuvendit
Dr. Aziz Thaci





REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 24 07-2017
PUNELI: 02/296
Nr.No.Br. 02/296

Kuvendi i Komunës
Nr.02/
Datë: 24.07.2017

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenit 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, bazuar në Statutin e Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës 12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e VII (shtatë) të mbajtur më datë:19.07.2017 mori këtë:

V E N D I M
PËR NDALIMIN E EKSURSIONEVE PËR MATURANTËT E KOMUNËS SË
MALISHEVËS JASHTË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 1

Miratohet kërkesa e anëtarëve të Kuvendit për ndalimin e ekskursioneve rekreative jashtë Republikës së Kosovës, për maturantët e shkollave të mesme të larta në Komunën e Malishevës.

Neni 2


Për zbatimin e këtij vendimi kujdesët: Kryetari i Komunës, përmes drejtorisë për Arsim dhe Edukim.

Neni 3

Ky vendim do të hyjë në fuqi nga dita e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, përkatësisht pas plotësimit të kriterëve ligjore të parapara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës.


Vendimi ju dërgohet;
Arkivit të Komunës
Drejtorisë për Arsim dhe Edukim
MAPL-së.

Kryesuesi i Kuvendit
Dr. Aziz Thaçi





REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës
Nr.02/
Datë: 24.07.2017

PRANILAR MË:
KONCERTSO ON: 24-07-2017
PRIML. #10:
Nr.No.Br. 02/294

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenit 24 dhe 40 paragrafi 2 pika c, Rregullores nr.02/244 datë: 09.09.2015 për ndarjen e subvencioneve dhe transferëve, kërkesës nr.01/837 datë: 10.07.2017 të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, në bazë të nenit 19 të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës 12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e VII (shtatë) të mbajtur më datë: 19.07.2017 mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet kërkesa nr.01/839 datë:11.07.2017 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për organizimin e Festivalit Folklorik "Oda e Llapushës", i cili do të organizohet me 1 dhe 2 Gusht të vitit 2017.

Neni 2

Shuma prej 3,000.00€ lejohet për kryerjen e pagesave sipas projekt-propozimit të Drejtorisë për Kulturë, rini dhe Sport.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Kryetari i Komunës, përmes drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorisë për Financa dhe Buxhet në Komunën e Malishevës.

Neni 4

Ky vendim do të hyjë në fuqi nga dita e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, përkatësisht pas plotësimit të kriterëve ligjore të parapara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës.

Vendimi ju dërgohet;
Arkivit të Komunës
Drejtorive të KK-së.
MAPL-së.

Kryesuesi i Kuvendit
Dr. Aziz Thaqi





REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës
Nr. 02/
Datë: 03.07.2017

PRANILJE
ACCEPTED ON: 05-07-2017
PRMILJENO:
Nr.No.Br. 02/234

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d, nenin 14 paragrafi 1, nenin 40, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin nr.02/L-26 për tokën bujqësore, mbështetur në Udhëzimin Administrativ nr.41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, kërkesën nr.01/774 datë: 23.06.2017 të Kryetarit të Komunës, Statutin e Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës:12.11.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë: 30.06.2017 mori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE

Neni 1

Miratohet kërkesa nr.01/625 e datës:18.05.2017 e parashtruar nga z.Ruzhdi Kryeziu nga fshati Bubavec Komuna e Malishevës, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Neni 2

Prona që kërkohet për ndërrimin e destinimit prej tokës bujqësore në tokë ndërtimore gjendet në Zonën kadastrale në Malishevë, njësia kadastrale nr.P-72310047-00641-5, me kulturë Mal i klasës 5, në sipërfaqe 996 m², dhe njësia kadastrale nr.P-72310047-00641-91 me kulturë Mal i klasës 5, në vendin e quajtur Zallina-Krshi Vogel në sipërfaqe 180 m², në emër të Ruzhdi Ajet Kryeziu.

Neni 3

Prona që kërkohet për ndërrim të destinimit është 600m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 0.11.76/ha, dhe pronari obligohet që paluajtshmerinë përkatëse ta shfrytëzoj sipas kërkesës së parashtruar.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen, kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtorisë për Urbanizëm.

Neni 5

Ky vendim do të hyjë në fuqi nga dita e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, përkatësisht pas plotësimit të kriterëve ligjore të parapara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës.

Vendimi ju dërgohet:
Arkivit të Komunës
Drejtorive të KK-së
Palës
MAPL-së.

Kryesuesi i Kuvendit
Dr. Aziz Thaçi





PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 24-07-2017
PRIMLJENJE:

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Dr.No.Br.

2/29



Kuvendi i Komunës
Nr.02/
Datë: 24.07.2017

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenit 24 dhe 40 paragrafi 2 pika c, Rregullores nr.02/244 datë:09.09.2015 për ndarjen e subvencioneve dhe transferëve, Rekomandimit nr.01/822 datë:11.07.2017 të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, në bazë të nenit 19 të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës 12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e VII (shtatë) të mbajtur më datë: 19.07.2017 mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet kërkesa nr.01/824 datë:11.07.2017, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionim të Klubit të Futbollit "UV-Malisheva"

Neni 2

Shuma prej 16,000.00€, lejohet për subvencionimin e Klubit të Futbollit "UV-Malisheva".

Neni 3

Ndarja e mjeteve të përcaktuar sipas nenit 2, behët për mbulimin e shpenzimeve për nevojat e Klubit të Futbollit.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdesët Kryetari i Komunës, përmes drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe drejtorisë për Financa dhe Buxhet.

Neni 5

Ky vendim do të hyjë në fuqi nga dita e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, përkatësisht pas plotësimit të kriterëve ligjore të parapara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës.

Vendimi ju dërgohet;
Arkivit të Komunës
Drejtorive të KK-së.
MAPL-së.

Kryesuesi i Kuvendit
Dr. Aziz Thaci





REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 24.07.2017
PRIMI LIBRO:
Nr.No.Br. 02 / 302

Kuvendi i Komunës
Nr. 02/____
Datë: 24.07.2017

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenit 52 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe bazë të nenit 19 dhe 27 të Statutit të Komunës së Malishevës Nr. 01/871, datë 12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në vazhdimin e mbledhjes së VII (shtatë) të mbajtur me datë: 21.07.2017 mori këtë:

V E N D I M
PËR ZËVENDËSIMIN E ANETARIT NË KOMITETIN PËR POLITIKË DHE FINANCA

Neni 1

Miratohet propozimi i anëtarëve të Kuvendit për shkarkimin e anëtares znj.Behie Sertolli nga Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 2

Anëtari i ri në Komitetin për Politikë dhe Financa z.Veton Kastrati, zëvendëson anëtares e deritanishme sipas pikës I të këtij vendimi.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Kuvendi i Komunës.

Neni 4

Ky vendim do të hyjë në fuqi nga dita e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, përkatësisht pas plotësimit të kriterëve ligjore të parapara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës.

Vendimi ju dërgohet:
Arkivit të Komunës
MAPL-së.

Kryesuesi i Kuvendit
Dr. Aziz Thaçi

